

Gjirokaster më 10.12.2023

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"ME-NAT" shpk**

Sot, më 10.12.2023, në, themeluesit, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, " Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr. 131/2015 Për QKB dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi dhe statuti nga ortakët:

- a) **Ramiz Bucj**, atësia Islam, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BF7388332, me numër personal identifikimi I70626115J i datëlindjes 26.06.1987, lindur në Gjirokaster dhe banues në Gjirokastër; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) **Alma Kore**, atësia Islam, shtetase shqiptare, identifikuar me anë të pasaportës me numër BF6779913, me numër personal identifikimi H85601113Q i datëlindjes 01.06.1978, lindur në Kruje dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme.

**Neni 1  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është "**ME-NAT**" shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
  - a) Shërbime Turistike.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga: Vangjel Koca, Nd.nr.7,H.14,Ap.32,Gjirokaster.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (një qind mije) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a) Ortaku themelues **Ramiz Buci**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 ( pesëdhjetë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b) Ortaku themelues **Alma Kore**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 ( pesëdhjetë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
  - 3) Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkruara dhe te shlyera krejtesisht, dhe depozituar ne nje llogari te hapur ne emër te shoqërise në një nga bankat e nivelit te dyte.

**Neni 6**  
**Administratori**

1. **Administratori** i shoqërisë emërohet:
  - a) **Ramiz BUCI**, atësia Islam, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BF7388332, me numër personal identifikimi I70626115J, i datëlindjes 26.06.1987, lindur në Gjirokaster dhe banues në Gjirokaster , me afat emërimi 5 vjeçar.

**Neni 7**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Mosmarrëveshjet**


- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ME-NAT" shpk**

**Ramiz BUCI**

  
(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

**Alma Kore**

  
(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)